



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Kryetari i Komunës
01.Nr.104/02-25441 /2020
Kaçanik, 13.10.2020



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Në bazë të Rregullores MF - Nr.04/2017

Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Zyra e Kryetarit bënë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM MBËSHTETJE FINANCIARE ME SUBVENCIONE PËR OJQ-TË

Qëllimi i thirrjes per aplikim:

Qëllimi i Thirrjes per Aplikim është dhënia e mbështetjes financiare me subvencione për OJQ-të për zbatimin e projekteve per zhvillimin e aktiviteveve kështilluese dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve që kanë të bëjnë me kujdesin ndaj mjedisit si dhe promovimin e bukurive natyrore të Komunës së Kaçanikut. Të gjitha Organizatat Joqeveritare (OJQ-të) të cilat ofrojnë shërbime lidhur me aktivitetet që kanë të bëjnë me ruajtjen, mbrojtjen e mjedisit, promovimin si dhe nxitjes se zhvillimit te turizmit malorë, mund të aplikojnë me projekt propozime për sigurimin e përkrahjes financiare me subvencione.

Projektet të cilat do të marrin përkrahje financiare duhet të kenë për objektiv zbatimin e aktiviteveve të përshkuara më lartë.

Kërkesa për aplikim duhet të përmban:

- Qëllimin e kërkesës/projektit;
 - Projekt Propozimi bashkë me koston totale dhe ;
 - Plotësimi i Formularit për aplikim (shkarko aplikacionin <http://kk.rks-gov.net/kacanik>
- Kliko : SHPALLET -----APLIKACIONET -----*

Kërkesës duhet ti bashkëngjiten edhe dokumentet :

- Certifikata e numrit të regjistrimit të organizatës;
- Certifikata e numrit fiskal të organizatës;
- Letërnjoftimi i personave/aplikantit /që përfaqëson organizatën;
- Xhirologaria dhe dëshmia e bankës në emër të organizatës;
- Dëshmi se nuk ka obligime organizata ndaj ATK;

Afati dhe procedura e aplikimit:

Afati per dorëzimin e Projekt-Propozimeve per mbështetje me subvencione eshte 15 ditë nga dita e shpalljes. Projekt-Propozimet me dokumentet e bashkëngjitura duhet te dorëzohen në objektin e Komunës së Kacanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5)

Vërejtje:

- *Aplikacioni i cili nuk përmban të dhënat e kërkuara dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar nuk do të shqyrtohet;*
- *Konkuruesit të cilët nuk kanë përmbyllur avanset e mëparshme ndaj këtij institucioni, nuk do të merren në shqyrtim;*
- *Aplikacionet të cilat dorëzohen jashtë afatit të kërkuar nuk do të shqyrtohen.*

